

VENDIM
Nr. 8, datë 16.1.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SHA, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL/FSHU SHA PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 5, pika 2, e VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, neneve 15, 19, pika 1, germa “P” dhe nenit 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 16.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga drejtoritë teknike nr. 5/5 prot, datë 13.1.2020, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë,

konstatoi se:

- ERE, në zbatim të nenit 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, VKM nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; vendimit të Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”, ngarkohet me detyrimin për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë.

- Për sa më sipër parashikuar në VKM nr. 244/2016, të ndryshuar, draftimi i një kontrate tip që të mbulojë më së miri nga pikëpamja ligjore por edhe rregullatore interesat, të drejtat dhe detyrimet e palëve ndaj njëra tjetrës, vjen si domosdoshmëri veçanërisht në fillim të vitit ushtrimor, por që lidhet njëkohësisht edhe me bërjen efektive të ndarjes së aktivitetit të OSHEE sh.a., duke ia lënë detyrimin e garantimit të furnizimit në cilësinë e furnizuesit të shërbimit universal, shoqërisë së krijuar dhe tashmë operative që nga 1 janari 2020, FSHU sh.a.

- Në draft kontratë, janë reflektuar edhe ndryshimet e fundit të VKM-së nr. 244/2016 (VKM nr. 883, datë 27.12.2019, ku parashikohet në nenin 5, pika 2, se: “Ndërmjet furnizuesit të shërbimit universal dhe shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nënshkruhet kontrata TIP, e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, e cila negociohet çdo vit, në lidhje me sasinë e energjisë së siguar dhe çmimin për njësi, përpara fillimit të çdo viti kalendarik të ushtrimit të aktivitetit”.

- Në kuptim të sa më sipër, janë palët që kanë detyrimin për të negociuar dhe nënshkruar me njëra-tjetrën kontratë të rinovuar për çdo vit ushtrimor, në të cilën të reflektohen dispozitat apo ndryshimet e dakordësuara që lidhen ekskluzivisht me elementet çmim dhe sasi.

- Me qëllim përmbushjen e detyrimit për sa më sipër, është draftuar kjo kontratë në frymën e kontratave të dakordësuara më herët edhe mes palëve e të konstatuara në përmbushje të parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe korrespondencat me shoqëritë e ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik, pjesëmarrësit e tjerë të tregut të energjisë elektrike, Autoritetin e Konkurrencës dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Draftkontrata propozohet e strukturuar në 23 nene dhe një shtojcë të cilat adresojnë çështje që lidhen me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik nga KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., si dhe rregullimin e marrëdhënies së shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve përfshirë në këtë kontratë dhe jo vetëm programimin dhe nominimin e sasive, por edhe marrëdhënien financiare mes tyre.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti